



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË,
TREGËTISË DHE ENERJITIKËS

Plani i Integruar i Ministrisë 2008

Shkurt 2008

Mesazhi i Ministrit



Plani i Integruar i Ministrisë (PIM) për vitin 2008 përfaqëson dokumentin e dytë të radhës të prezantuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Në dallim nga viti i kaluar, PIM 2008 prezanton një program më të qartë e të integruar, një program të mbështetur në objektiva dhe politika të qarta, tashmë të bazuara në një kuadër afatgjatë planifikimi siç është Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Nga ana tjetër, PIM 2008 përbën një dokument tërësisht të harmonizuar me PBA 2008 - 2010. Për herë të parë në këtë program janë integruar në mënyrë të plotë të gjitha proceset e planifikimit të parashikuara në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar si dhe detyrimet programore të METE në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe të integritit euro-atlantik.

Në ndryshim nga programi i vitit të kaluar, PIM 2008 është hartuar në kushtet kur METE ka një vizion të qartë për të ardhmen, një kuadër të konsoliduar politikash dhe programesh, të cilat tashmë janë pjesë integrale dhe një mbështetje e drejtpërdrejtë në drejtim të zbatimit të objektivave të Programit të Qeverisë. METE ka përfunduar ciklin e rishikimit të të gjitha politikave dhe strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale të parashikuara në programin e Qeverisë, siç është Strategjia Kombëtare e Energjisë, Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, Strategjia e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut dhe Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rajonal, si dhe ka ristrukturuar programet dhe buxhetin e saj në përputhje me indikacionet e këtyre strategjive dhe synimet afatgjata të zhvillimit të vendit.

Në aspektin e programeve, PIM 2008 prezanton tërësinë e angazhimeve vjetore të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zhvillimin e sektorit energjetik, të masave për zhvillimin e një tregu kompetitiv dhe që garanton konkurrencën e lirë dhe eliminon diskriminimet në treg, të masave për përmirësimin e klimës së biznesit dhe tërheqjen e investimeve të huaja, reduktimin e barrierave administrative dhe uljen e kostos së çeljes së bizneseve, përmirësimin e bilancit tregtar përmes nxitjes së eksporteve vendase, përshejtimin e privatizimit të sektorëve strategjike dhe garantimin e transparencës së procesit të privatizimeve. Në këtë kontekst, viti 2008 do të shënojë një hap të mëtejshëm në drejtim të përmirësimit të imazhit të Shqipërisë si një vend atraktiv si për biznesin vendas ashtu dhe për biznesin e huaj.

Në fushën e privatizimit, gjatë vitit 2008 do të realizohet privatizimi i Operatorit të Shpërndarjes të KESH sh.a dhe ARMO. Ndërkohë, paralelisht do të punohet për nxitjen dhe zgjerimin e politikave të partneritetit me sektorin privat si dhe promovimin dhe zgjerimin e skemës së koncesioneve. Në fushën e shfrytëzimit të burimeve natyrore gjatë vitit 2008 do të punohet për vlerësimin, promovimin, nxitjen e investimeve, përafrimin e legjislacionit, monitorimin e strategjive sektoriale.

Në sektorin energjetik, tashmë METE ka një kuadër të kompletuar politikash afatgjata për zhvillimin e këtij sektori. Ka përfunduar përgatitja e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2007 - 2020, e cila tashmë është pjesë integrale e Strategjisë

Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Gjatë vitit 2008 do të punohet për kompletimin e kuadrit ligjor, për sigurimin e financimeve të nevojshme për përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës, rritjen e kapaciteteve të shkëmbimit të energjisë dhe për hapjen dhe integrimin e mëtejshëm të sistemit elektroenergjetik shqiptar në sistemin rajonal të energjisë. Përparësi gjatë këtij viti do të jetë edhe rritja e eficiencës së shfrytëzimit të burimeve energjetike të vendit, përdorimi sa më ekonomik dhe me ndikim minimal në mjedis i produkteve energjetike, nxitja e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë (HEC-et e vegjël, erës diellore dhe biomasës), për të bërë të mundur shfrytëzimin në maksimum të burimeve lokale të energjisë.

Gjatë vitit 2008, në kuadër të programeve të saj afatgjata, METE do të hedhë hapa konkrete në drejtim të inkurajimit të zhvillimit të biznesit përmes mbështetjes që do të jepet përmes Fondit të Garantimit të Kredive dhe Fondit të Konkurrueshmërisë. Po kështu gjatë vitit 2008 do të reduktohen më tej barrierat e biznesit, do të thjeshtohen dhe standartizohen procedurat e regjistrimit të biznesit në përputhje me praktikat ndërkombëtare, do të nxitet zhvillimi i infrastrukturave me teknologji të lartë dhe zhvillimi i zonave ekonomike.

Gjatë vitit 2008 bashkëpunimi ekonomik dhe tregtar do të zgjerohet më tej, si në planin rajonal ashtu dhe atë ndërkombëtar. Nga ana tjetër, në kuadër të bashkëpunimit rajonal gjatë vitit 2008 do të thellohet më tej edhe bashkëpunimi në sektorin elektroenergjetik me synim harmonizimin e politikave të vendit për zhvillimin e këtij sektori me politikat e rajonit në tërësi, gjë që mundëson jo vetëm një përdorim më racional të burimeve energjetike të vendit, por edhe një menaxhim efikas të burimeve financiare të sektorit publik. Në vitin 2008 do të finalizohet nënshkrimi dhe ratifikimi në Kuvend i marrëveshjes së tregtisë së lirë me vendet e EFTA-s.

Së fundi, do të shpreheshim se METE në bashkëpunim me ministritë, rrethet akademike të vendit dhe të gjithë aktoret e interesit, ka mundësuar përgatitjen e një strategjie dhe të një plani veprimi për zhvillimin rajonal, e cila synon zbutjen e diferencave në zhvillim mes qarqeve dhe integrimin e zonave ekonomikisht të pafavorizuara në proceset e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Gjatë vitit 2008 do të punohet me përparësi për përgatitjen e kuadrit ligjor dhe institucional për menaxhimin e politikave të zhvillimit rajonal, si në nivel qendror ashtu dhe në nivel lokal.

Genc Ruli



Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë	5
2	Dokumentat Strategjikë të Ministrisë	6
3	Programet buxhetore të Ministrisë	9
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008.....	10
5	Plani i Monitorimit i Ministrisë	15
Aneks 1	Projekt-ligjet për t'u paraqitur.....	16
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin Evropian.....	17
Aneks 3	Investimet publike	22
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj	24
Aneks 5	Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit	25

1 Misioni i Ministrisë

Harton dhe zbaton politika që nxisin rritjen dhe stabilitetin ekonomik, mundësojnë një zhvillim të qëndrueshëm dhe perspektiv të burimeve energjetike të vendit, mundësojnë administrimin me efikasitet të pronës publike dhe privatizimin e saj, përmirësojnë klimën e biznesit dhe nxisin tërheqjen e investimeve të huaja, mundësojnë lëvizjen e lirë të mallrave dhe krijimin e një tregu të sigurtë dhe të hapur ndaj konkurrencës, e që nxisin e zhvillojnë bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar.

2 Dokumentat Strategjike të Ministrisë

Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2007 - 2013

Strategjia ka si qëllim të mbështesë objektivin e qeverisë për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme, përmes zhvillimit të sipërmarrjes, përmirësimit të klimës së biznesit dhe investimeve, aplikimit të politikave nxitëse për eksportet, shfrytëzimit më të mirë të burimeve financiare e natyrore të vendit, rritjes së produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së biznesit si dhe krijimit të një partneriteti afatgjatë dhe të qëndrueshëm shtet-biznes.

Strategjia ka një plan të detajuar financiar, në të cilin janë inkluduar edhe kostot që gjenerohen në zbatim të Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve është miratuar me VKM Nr.795, datë 11.07.2007.

Strategjia Kombëtare e Energjisë 2007 - 2020

Rishikimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë ka përfunduar. Strategjia është miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe është integruar në dokumentin përfundimtar të SKZHI. Në dokumentin e miratuar janë reflektuar mendimet dhe sugjerimet e ministrave dhe institucioneve përgjegjëse përfshirë aktorët e interesit.

Strategjia Kombëtare e Energjisë përcakton drejtimit kryesore për një zhvillim të qëndrueshëm dhe perspektiv të sistemit energjetik, për krijimin e një sistemi eficient dhe të bazuar në parimet e tregut, të një sistemi që garanton sigurinë e furnizimit dhe plotësimin me kosto minimale të kërkesës së agreguar për energji dhe që merr në konsideratë edhe mbrojtjen e mjedisit. Strategjia mundëson një hapje efektive të tregut të brendshëm të energjisë elektrike si dhe pjesëmarrjen aktive në tregun rajonal të energjise në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë të vendeve të Evropës Juglindore, si dhe kërkesave të Bashkimit Evropian për reformimin e tregut të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal 2007 - 2013

Strategjia përcakton politikat bazë për mundësimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të balancuar social-ekonomik të të gjithë rajoneve të vendit, tërheqjen dhe integrimin në proceset e zhvillimit të zonave të pafavorizuara me synim reduktimin e pabarazive rajonale në zhvillim. Strategjia përcakton premisat për hartimin e kuadrit ligjor, kuadrit të menaxhimit dhe të programeve që do të zbatohen për zhvillimin e qarqeve dhe të zonave të pafavorizuara, përfshirë ngritjen e kapaciteteve të zhvillimit në qarqe me qëllim përdorimin dhe menaxhimin sa më fikas të potencialeve të tyre të zhvillimit.

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal është përgatitur nga METE në bashkëpunim me 9 ministri të tjera dhe është asistuar nga PNUD. Dokumenti i plotë i strategjisë është miratuar me VKM nr. 773, datë 14.11.2007 së bashku me planin e veprimit për periudhën 2008 - 2009.

Strategjia Ndërsektoriale e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2007 - 2013

Strategjia synon të sigurojë një mbrojtje efektive për konsumatorët dhe të mbështetur në një kuadër ligjor solid, përfshirë këtu sigurimin e bazës institucionale që do të merret me mbikëqyrjen e tregut për produktet industriale dhe ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Në zbatim të kësaj strategjie, Shqipëria do të ketë një kuadër ligjor të harmonizuar me atë të Bashkimit Evropian si dhe kapacitetet e nevojshme administrative për administrimin e ligjit, që do të bëjë që konsumatori shqiptar të mbrohet në mënyre efektive nga risqet dhe kërcënimet me të cilat ai përballet dhe të cilat ai nuk mund t'i trajtojë në mënyre individuale.

Strategjia është përgatitur në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Dokumenti i Strategjisë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut është miratuar me VKM Nr. 797, datë 14.11.2007.

Strategjia sektoriale për Infrastrukturën e Cilësisë

Strategjia e Infrastrukturës së Cilësisë është miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin nr.272, datë 05.03.2008. Strategjia shënon hapin e parë drejt harmonizimit të politikave dhe objektivave të institucioneve të Infrastrukturës së Cilësisë, që ka një rol parësor jo vetëm në garantimin e sigurisë së produkteve por dhe në eliminimin e barrierave teknike në tregti duke nxitur eksportet dhe rritur shkëmbimin e mallrave.

Kjo strategji pas një vlerësimi real të gjendjes aktuale të Infrastrukturës së Cilësisë në Shqipëri, përcakton objektivat afat-mesme të zhvillimit. Theksojmë së termi “afat-mesëm” për vetë problematikën që bart çdo institucion i Infrastruktures së Cilësisë në aspektin e investimeve, është përcaktuar 15 vjet për zhvillimin e metrologjisë, 10 vjet për akreditimin dhe 5 vjet për standardizimin.

Strategjia është në përputhje me të gjitha praktikat e BE -së në këtë fushë, Dokumentin e Partneritetit Evropian 2007, MSA si dhe PKZMSA.

Zbatimi i kësaj strategjie do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e integritit evropian, garanton sigurinë e produkteve të vendosura në tregun shqiptar, ndihmon në eliminimin e barrierave teknike në tregti, duke sjellë rritjen e vëllimit të shkëmbimeve tregtare si dhe në rritjen e aftësisë konkurruese të kompanive shqiptare.

Qëllimet

Politikat e Ministrisë janë hartuar me synim arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Përmirësimi i eficiencës së shfrytëzimit të ndërmarrjeve të sektorit publik nëpërmjet ristrukturimit dhe privatizimit të shoqërive shtetërore në sektorët strategjike të energjisë elektrike dhe të naftës, përfshirë edhe privatizimin e shoqërive me kapital shtetëror dhe aseteve të sektorëve jo-strategjik (SME-ve).
- Forcimi i partneritetit publik-privat dhe nxitja e investimeve koncesionare në sektorin energjetik dhe industrial.
- Nxitja e një shfrytëzimi sa më eficient të burimeve energjetike të vendit si dhe të përdorimit sa më ekonomik dhe me ndikim minimal në mjedis të produkteve energjetike, në funksion të objektivave për një zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit.
- Rritja e sigurisë së furnizimit me burime energjetike nëpërmjet diversifikimit të sistemit energjetik dhe ndërtimit të veprave të reja gjeneruese dhe linjave të interkonjeksionit, nxitjes së përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë (HEC-et e vegjël, erës diellore e biomasës), për të bërë të mundur shfrytëzimin në maksimum të burimeve lokale
- Hapja e tregut të brendshëm të energjisë dhe integrimi i tij në tregun rajonal të energjisë, në përputhje me objektivat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë të Vendeve të Evropës Juglindore, si dhe zbatimit të kërkesave të Bashkimit Evropian për reformimin e sektorit elektroenergjetik (Direktiva 54/2003 e BE-se).
- Sigurimi i një rritje të qëndrueshme ekonomike përmes rritjes së produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së biznesit, krijimit të vendeve të reja të punës, përmirësimit të ambientit rregullator, reduktimit të informalitetit në ekonomi, nxitjes së prodhimeve për eksport, thithjes së investimeve të huaja, krijimit të zonave ekonomike.
- Krijimi i kushteve për lëvizjen e lire të mallrave si dhe sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së jetës, shëndetit dhe interesave ekonomike të konsumatorëve si dhe mbrojtjen e të drejtave të pronarëve të objekteve të pronësisë industriale.
- Zhvillimi i industrisë minerare në Shqipëri dhe përgatitja e politikave të zhvillimit dhe integritit të aktivitetit minerar në ekonominë në shkallë vendi për vlerësimin e potencialit mineral-mbajtës i vendit tonë dhe futjen në qarkullim me efektivitet ekonomik të grup mineraleve tradicionale, atyre të rinj, si edhe promovimin e tyre.
- Promovimi dhe shfrytëzimi racional i burimeve natyrore, miradministrimi i territorit dhe gjeomjedisit në shërbim të komunitetit.
- Forcimi i kapaciteteve të planifikimit afatgjatë për një menaxhim sa më efektiv të politikave dhe programeve sektoriale si dhe të burimeve financiare për zbatimin e tyre.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi konsiston në planifikimin, menaxhimin dhe administrimin e burimeve financiare, njerëzore dhe materiale mbështetur në Programin e Qeverisë; koordinimi dhe monitorimi i programeve të METE, bazuar në PIM, SKZHI dhe PBA.

3.2 MBËSHTETJE PËR ENERGJINË

Politika e këtij programi konsiston në: zhvillimin e politikave dhe strategjive për zhvillimin e sektorit elektrik dhe tregut të energjisë, në zbatim të Direktivave të Bashkimit Evropian; garantimin e një furnizimi të sigurt të ekonomisë me burime energjetike për të siguruar një zhvillim të shpejte dhe të qëndrueshëm ekonomik e njerëzor të vendit si dhe për integrimin e vendit në BE; mbrojtjen e mjedisit në sektorin energjetik dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore tokësore dhe nëntokësore.

3.3 MBËSHTETJE PËR BURIMET NATYRORE

Politika e këtij programi konsiston në kryerjen e studimeve dhe projekteve të rëndësishme në fushën e gjeoshkencave, për promovimin dhe shfrytëzimin racional të burimeve natyrore, monitorimin post mineral dhe parandalimin e rrezikut mineral, miradministrimin e territorit dhe gjeomjedisit në shërbim të komunitetit dhe në dobi të vendimmarrjes për planifikimin territorial në nivel lokal dhe qendror.

3.4 MBËSHTETJE PËR MINIERAT DHE NDËRMARRJET PUBLIKE

Politika e këtij programi konsiston në monitorimin dhe mbylljen e objekteve minerare e gjeologjike, mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisit në zonat minerare të shfrytëzuara dhe privatizimin e aseteve; rritjen e sigurisë në punë në minierat me aktivitet prodhues; konservimin dhe privatizimin e aseteve të industrisë prodhuese.

3.5 MBËSHTETJE PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Politika e këtij programi konsiston në zhvillimin e politikave të sektorit privat përmes reduktimit të barrierave të biznesit, thjeshtimit dhe standartizimit të tyre në përputhje me praktikat ndërkombëtare, nxitjes së investimeve të huaja, eksportit të mallrave dhe shërbimeve, nxitjes së zhvillimit të infrastrukturave me teknologji të lartë, hartimit të platformave dhe programeve për ristrukturimin dhe privatizimin e shoqërive tregtare dhe zhvillimit të zonave ekonomike.

3.6 MBËSHTETJE PËR MBIKQYRJEN E TREGUT, INFRASTRUKTURËN E CILËSISË DHE PRONËSISË INDUSTRIALE

Politika e këtij programi konsiston në heqjen e barrierave teknike për sigurimin e lëvizjes së lirë të mallrave, funksionimin e një sistemi efektiv të mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së pronësisë industriale.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2008.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Rritja e efciences së përdorimit të burimeve financiare, njerëzore e materiale të ministrisë me synim arritjen e objektivave të ministrisë në kuadër të programeve dhe strategjive sektoriale të përfshira në SKZHI.
- Përgatitja e programeve afatshkurtra dhe afatmesme të buxhetit, përgatitja e dokumentave strategjike për ndihmen e huaj dhe prioritetet afatmesme të ministrisë, të planeve të integruara të ministrisë, përgatitja dhe administrimi i kuadrit rregullator për bashkëpunimin bilateral ekonomik dhe tregtar dhe mbrojtjen reciproke të investimeve. Azhornimi i politikave, programeve dhe strategjive në mbështetje të zhvillimit ekonomik.
- Monitorimi dhe vlerësimi i politikave dhe programeve sektoriale me synim përmirësimin e cilësisë së planifikimit dhe të menaxhimit të burimeve, azhornimit të politikave dhe programeve dhe përmbushjes së misionit të ministrisë.
- Zbatimi i planit kombëtar të zbatimit të MSA në terma afat-shkurtër.

Produktet që do të ofrohen:

- Programi vjetor dhe afatmesëm i buxhetit;
- Plani i Integruar i Ministrisë; Dokumenti për Politikën Prioritare të Ministrisë; Raporti Monitorimit të Projekteve me Financim të Huaj; Marrëveshje për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Tregtar Bilateral, Marrëveshje për Nxitjen dhe Mbrojtjen Reciproke të Investimeve; Botime;
- Raporti vjetor për zbatimin e MSA-së, raportet mujore në kuadër të zbatimit të PKZMS

4.2 MBËSHTETJE PËR ENERGJINË

Objektivat e politikës

- Vazhdimi i procesit të konsolidimit të shoqërive të krijuara nga ristrukturimi i KESH sh.a., Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).
- Realizimi i procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, vazhdimi i procedurave të privatizimit të shoqërisë ARMO sh.a.
- Dhënia me koncesion e hidrocentraleve.
- Përgatitja e kuadrit ligjor, në përputhje me direktivat e BE-së për nxitjen e ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike.
- Ndërtimi i kapaciteteve të reja të prodhimit të energjisë elektrike dhe përmirësimi i strukturës së prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve të reja termike. Kryerja e studimit dhe përgatitja e skemave të shfrytëzimit të lumit Vjosë.

- Rritja e sigurisë së digave të hidrocentraleve dhe paisja e tyre me sisteme dhe pajisje për monitorimin e tyre.
- Rritja e mundësive për thithjen e investimeve strategjike në sektorin hidrokarbur.
- Diversifikimi i burimeve të furnizimit me burime energjetike hidrokarbure.
- Garantimi i një furnizimi të sigurt të vendit me burime energjetike hidrokarbure.
- Përgatitja e kuadrit ligjor dhe rregullator për zhvillimin e tregut të gazit natyror.
- Rritja e efikasitetit të energjisë nëpërmjet përdorimit të lëndëve djegëse alternative.

Produktet që do të ofrohen

- Perfundimi i procedurave për privatizimin e sektorit të shpërndarjes së energjisë elektrike (OSSH) dhe të shoqërisë ARMO.
- Raporti i Bilancit Energjetik;
- Kuadri ligjor për burimet e rinovueshme.
- Rritja e numrit të hidrocentraleve të dhëna me konçension
- Përgatitja dhe miratimi projektligjit “Për sektorin e gazit natyror”, përgatitja e akteve nënligjore ;
- Rritja e prodhimit të naftës bruto në masën 10%;
- Realizimi i Marrëveshjeve Hidrokarbure për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve;
- Rishikimi i kuadrit ligjor dhe institucional për mbajtjen e menaxhimin e rezervës së sigurisë, referuar edhe direktivave të BE;
- Përgatitja e kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit nr. 9876, datë 14.02.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lendeve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”.

4.3 MBËSHTETJE PËR BURIMET NATYRORE

Objektivat e politikës

- Përmirësimi i administrimit të territorit dhe burimeve natyrore; studimi i ujrave nëntokësore, resurseve minerale: monitorimi i gjeomjedisit dhe shmangia e rreziqeve gjeologjike;
- Përmirësimi i sistemit të informacionit; studime dhe projektme për nevoja emergjente sipas kërkesave të pushtetit lokal; promovimi i mineraleve të rinj për shfrytëzim;
- Mbikqyrja e Shfrytëzimit Efektiv të Pasurive Minerale; monitorimi i fenomeneve post shfrytëzimit dhe uzinave metalurgjike; përpunimi i direktivave të BE-së.

Produktet që do të ofrohen

- Raport vjetor mbi rezultatet e monitorimit për çdo basen;
- Raport studimor i rivlerësimit gjeologo ekonomik;
- Ndërtim i hartave shumëqëllimore të shkallës 1:25000.
- Raport vjetor mbi rezultatet e arritura;

- Raport studimor për tematikat e rrezikut gjeologjik në rrethet e Elbasanit, Pogradecit, Pukës;
- Relacionet studimore me përfundimet përkatëse dhe sipas rastit me projektimin e shpimeve për ujë;
- Raporte për shfrytëzimin e rezervave minerare nga subjektet private të licencuara;

4.4 MBËSHTETJE PËR MINIERAT DHE NDËRMARRJET PUBLIKE

Objektivat e politikës

- Vazhdimi i mbylljes së minierave të shfrytëzuara dhe jo efektive, privatizimi i aseteve për minierat e kromit, bakrit, hekur-nikelit dhe qymyreve; përfundimi i mbylljes së minierave të qymyreve; transferimi i tyre tek pushteti lokal.
- Rritja e sigurisë në punë; pajisja me mjete pune bashkëkohore të repartit të Inspektim-Shpëtimit të Minierave; monitorimi dhe kontrolli i specializuar i objekteve minerare dhe masat për eliminimin e rreziqeve.
- Konservimi dhe privatizimi i aseteve të industrisë prodhuese

Produktet që do të ofrohen

- 30 objekte minerare të mbyllura;
- Sisteme të specializuara për monitorimin dhe kontrollin e objekteve minerare ;

4.5 MBËSHTETJE PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Objektivat e politikës

- Mbështetje financiare në vlerë prej 25 Milion Lekë, për kompanitë e vogla e të mesme, për t'u bërë konkurruese në tregun rajonal; ngritja e fondit për garantimin e kredive të eksportit; ngritja e strukturës së menaxhimit të fondit të garantimit të kredive;
- Zgjerimi i linjave të kreditimit të SME-ve me 15%.
- Zbatimi i programit të transferimit të pronës shtetërore drejt sektorit privat, nëpërmjet zbatimit të kontratave të koncesionit në sektorët e energjisë, minierave etj;
- Forcimi i kapaciteteve të Agjensive ALBINVEST, ATRAKO dhe QKR.
- Zhvillimi i infrastrukturës fizike për parqet industriale.

Produktet që do të ofrohen

- Projekte koncesioni të vlerësuara dhe të monitoruara;
- Kredi dhe garanci për SME;
- Sistemi për matjen e impaktit të kuadrit ligjor në SME (RIA);
- Përgatitja e bazës ligjore dhe infrastrukturës fizike për parqet industriale;
- Dokumenti strategjik i novacionit dhe transferimit të teknologjisë;
- Studime, botime.

4.6 MBËSHTETJE PËR MBIKQYRJEN E TREGUT, INFRASTRUKTURËN E CILËSISË DHE PRONËSISË INDUSTRIALE

Objektivat e politikës

- Përafrimi i legjislacionit në fushën e standardizimit, mbikqyrjes së tregut, akreditimit, metrologjisë e pronësisë industriale,
- Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të strukturës së mbikëqyrjes së tregut (sot IQT) si dhe akreditimi i laboratorëve ekzistues në IQT. Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve të Infrastrukturës së Cilësisë dhe Drejtorisë së Patentave dhe Markave për zbatimin e MSA-së.

Produktet që do të ofrohen

- Miratimi i Strategjisë “Për zhvillimin e Infrastrukturës së Cilësisë në Shqipëri”
- Miratimi i projektligjit për Pronësinë Industriale;
- Miratimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8488 date 13.05.1999 ‘Për Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara”;
- Hartimi i 5 rregulloreve nga Drejtoria e Patentave dhe Markave;
- Miratimi i projektvendimit “Për funksionimin dhe organizimin e strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut”
- Miratimi i VKM “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Akreditimit”
- Miratimi i 4 projektvendimeve nga Drejtoria e Standardizimit
- 10 akte nënligjore për metrologjinë;
- Kryevlerësues dhe vlerësues teknik të trajnuar për kryerjen e shërbimit të akreditimit;
- 15 persona të trajnuar dhe dy laboratorë të akredituar në IQT
- Zgjerimi i stafit me 3 specialiste në Drejtorisë së Markave dhe Patentave
- Krijimi i qendrave rajonale në Korçë dhe Lezhë (6 laboratore);
- Krijimi i fushave të reja të matjes dhe ngritja e nivelit teknik të atyre ekzistues me etalonë kombëtare matjeje.
- Dy laboratorë kalibrimi në DPM të akredituara
- Projektimi i Institutit Kombëtar për Metrologjinë;
- Standardet evropiane në dispozicion të biznesit nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit;
- Adoptimi si standarde Shqiptare i 80% të standarteve evropiane

Tabela Buxheti 2008 sipas programeve dhe llojeve te shpenzimeve, milion Lek

Programet	Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqërore 600, 601	Mallra dhe shërbime 602	Subvencionet 603	Të tjera transferata korrente 604, 605	Transferata për buxhetet familjare dhe individët 606	Shpenzi me kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	188	151	0	70	0	26	435
Mbështetje për Energjinë	0	1	0	0	0	129	130
Mbështetje për burimet natyrore	0	0	0	0	0	265	265
Mbësht. Miniera e Nd/je Publike	42	9	0	0	0	33	84
Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	99	37	0	20	0	1.681	1.837
Mbështetje për Mbikq. e Tregut, Infrast. e Cilës. dhe Pron. Industr.	147	52	0	24	0	218	441
Total	476	250	0	114	0	2.352	3,192

5 Plani i Monitorimit i Ministrisë

Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2008.

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Programi: Planifikim, Menaxhim, Administrim		
1. Përgatitja e Dokumenteve Strategjike në kuadër të zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (Dokumenti i PIM 2008; Dokumenti i PBA)	Nr.	2
Programi: Mbështetje për Energjinë		
2. Përgatitja e kuadrit ligjor për sektorin e gazit natyror dhe kuadrit nenligjor për energjitë e rinovueshme	Ligj VKM	1 3
3. Zhvillimi i Zonës energjetike dhe industriale të Porto Romano me qëllim diversifikim e burimeve energjetike	VKM për miratimin e studimit	1
Programi: Mbështetje për Minierat dhe Ndërmarrjet Publike		
4. Miniera të shfrytëzuara dhe joefektive të mbyllura	Nr.	30
Programi: Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik		
5. Privatizimi i sektoreve strategjike (OSSH-së dhe ARMO-sha)	Nr. kontratash	2
6. Zhvillimi i zonës ekonomike të Spitallës (Ndërtimi i nënstacionit elektrik të Spitallës)	Nr.	1
7. Niveli i eksporteve dhe fluksi i investimeve të huaja	Mln Euro	890 dhe 460
8. Numri i ndërmarrjeve të reja	Nr.	12000
9. HEC dhe TEC të dhëna me koncesion	Nr.	50
Programi: Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale		
10. Hartimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e standardizimit, akreditimit, metrologjisë dhe mbikëqyrjes së tregut dhe pronësisë industriale.	Ligje VKM Rregullore	2 17 5

Aneks 1 Projekt-ligjet për t'u paraqitur

- Projektligj “Për Zhvillimin Rajonal“
- Projektligji “Për amendimin e Marrëveshjes TRIPS”
- Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Tregtisë së lirë Shqipëri - EFTA”,
- Projektligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”
- Projektligji “Për organizimin e panairove dhe ekspozitave tregtare”
- Projektligj “Për firmën elektronike”
- Projektligji “Për mbrojtjen e konsumatorëve”
- Projektligj “Për një ndryshim në ligjin nr. 9221 datë 15.4.2004, “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”, i ndryshuar”
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.7796 dt.17.2.1994 “Minerar i Shqipërisë”
- Projektligji “Për inspektoriatin Shtetëror të Kontrollit dhe Shpëtimit në Miniera”
- Projektligji “Për pronësinë industriale”
- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8488 datë 13.05.1999 “Për mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të integruara”.
- Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9072, date 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë”
- Projekt - ligji “Për energjitë e rinovueshme”
- Projektligji” Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”.
- Projektligji” Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 9072, date 22.05.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike, i ndryshuar”

Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin Evropian

Direktivat e përqasjes së Re dhe të Vjetër, Mbrojtjes së Konsumatorit dhe mbikëqyrja e tregut

- Projekt VKM për “Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit për paisjet elektrike të tensionit të ulët”;
- Projekt VKM për “Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit për përputhshmërinë elektromagnetike”;
- Projekt VKM për “Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit për makineritë dhe ashensorët”
- Projekt VKM për “Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të paisjeve dhe sistemeve mbrojtëse në mjedise potencialisht shpërthyes”,
- Projekt VKM për “Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të produkteve në lidhje me paketimin dhe paketimin e mbetjeve”;
- Projekt VKM për “Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të paisjeve shtëpiake frigoriferike dhe ngrirës në lidhje me kërkesat e efikasitetit për energji”;
- Projekt VKM për “Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të produkteve në lidhje me etiketimin e konsumit të energjisë”;
- Projekt VKM për “Kërkesat e efikasitetit të energjisë për paisjet e vogla elektronike dhe ndriçimin fluoreshent”;
- Projektvendimi “Për detegjimet”;
- Hartimi i dy akteve nënligjore në zbatim të Ligjit të Mbrojtjes së Konsumatorëve nëpërmjet transpozimit të plotë të direktivave evropiane
 - Mbi respektimin e kontratave në distancë, dhe
 - Respektimi i kontratave të negociuara jashtë qendrave të biznesit;
- Fushatë ndërgjegjësuese për konsumatorin dhe operatorët ekonomikë për kuadrin ligjor që ka lidhje me mbikëqyrjen e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorëve;
- Ngritja dhe fuqizimi i strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut (sot IQT)
- Fuqizimi i kapaciteteve të institucionale të stafit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut
- Zbatimi i aktiviteteve të Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut, në lidhje me produktet industriale, të parashikuara në planin e veprimit për vitin 2008.

Akreditimi

- Projektvendim “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Akreditimit”
- Akreditime të përbashkëta me organizma anëtare të EA
- Ndjekja e takimeve evropiane dhe ndërkombëtare për fitimin e eksperiencës së organizmave të tjerë akreditues
- Trajnimi i stafit të DA, kryevlerësuesve/vlerësuesve. Përgatitja e gjithë dokumentacionit të nevojshëm për anëtarësim në EA (rishikim, risistemim, dhe përkthim)

- Caktimi i fushës për nënshkrimin e EA-MLA dhe aplikimi për nënshkrimin e MLA
- Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave të menaxhimit dhe skemave të akreditimit
- Pjesëmarrje në aktivitetet evropiane të akreditimit dhe ndërkombëtare
- Promovimi i DA dhe shërbimeve të saj nëpërmjet organizimit të seminareve dhe workshopeve, si dhe dizenjimin, publikimin dhe shpërndarjen për promovim
- Para vlerësimi i DA nga ekspertë evropian, kryerja e kontrolleve të brendshme dhe korrigjimi i moskonformiteteve

Standardizimi

- Plotësimi i 9 kushteve për t'u bërë anëtare me të drejta të plota në CEN dhe CENELEC, pjesëmarrje e KT në punën Evropiane të standardizimit, trajnim i sekretarëve të KT
- IT dhe Internet connection i rrjetit të DPS-s
- Materiale promovimi në formë dhuratash e seminare/workshop-e
- Adoptimi i 80% të standardeve Evropiane të CEN dhe CENELEC si standarde shqiptare

Metrologjia

- Përmirësimi dhe fuqizimi i infrastrukturës së Qendrave Rajonale të kontrollit të instrumentave matëse (4 Qendra): studim, trajnim stafi teknik, blerje pajisjesh
- Ndërtimi i dy qendrave rajonale: Korçë dhe Lezhë
- Projekt VKM “Për kontrollin e produkteve të paketuara”, “Për kontrollin e shisheve si enë matëse”, “Për etalonët kombëtare të matjeve”, “Për Karakteristikat metrologjike dhe teknike të instrumentave matëse ligjërisht të kontrolluara”, “Për funksionimin dhe organizimin e DPM” dhe “Për njësite ligjore të matjes”
- Projektudhëzim i përbashkët me Ministrinë e Financave: “Për tarifën e shërbimeve të DPM-së” dhe “Për përdorimin e të ardhurave të DPM-së”
- Projekt urdhëra i Ministrit të METE “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Metrologjisë” dhe “Për juridiksionin territorial të Qendrave Rajonale”

E drejta e vendosjes

- Ngritja e sektorit “Për reformën në fushën e legjislacionit tregtar”
- Përgatitje për zbatimin e ligjit të ri për shoqëritë tregtare
- Miratimi i Ligjit të ri “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- Përgatitja e Komentarit për Ligjin e ri “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Pronësia industriale

- Ndjekja e procedurave për aprovimin e projekt ligjit për PI.
- Ndjekja e procedurave për aprovimin e Projektligjit ” Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8488 datë 13.05.1999 “Për Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara”.
- Hartimi i Rregullores për regjistrimin e patentave dhe modeleve të përdorimit.
- Hartimi i Rregullores për regjistrimin e dizenjove industriale.
- Hartimi i Rregullores për regjistrimin e markave tregtare dhe të shërbimit.

- Hartimi i Rregullores për regjistrimin e treguesve gjeografik.
- Hartimi i Rregullores për funksionimin e DPM.
- Hartimi i sistemit të ri tarifor.
- Zgjerimi i stafit me 3 specialiste.
- Fillimi i procedurave për aderimin në Konventën Evropiane të Patentave.
- Nënshkrimi i protokolleve të Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.
- Trajnimi i stafit të Drejtorisë së Patentave, Markave dhe përfaqësuesve të autorizuar.
- Organizimi i seminareve për ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me promovimin e PI, hartimi i një kalendari për këtë qëllim.
- Përmirësimi dhe Administrimi i infrastrukturës së Arshivës, krijimi i regjistrit për çdo objekt të PI.
- Përgatitja e booklet-eve me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e të gjitha kategorive të interesuara.

Ndihma shtetërore

- Ndërgjegjësimi publik për konceptin e ndihmës shtetërore (konferenca, trajnime, seminare fushata promovimi, broshura etj).
- Shtimi i kapaciteteve institucionale të strukturave të ndihmës shtetërore me katër punonjës të rinj.
- Udhëzim për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve publike.
- VKM për miratimin e Raportit Vjetor për Ndhimat Shtetërore, i cili do të dërgohet në Komisionin Evropian.
- Udhëzim për metodologjinë e analizës së kostove standarde të ndihmës shtetërore dhe modelet e deklarimit të informacionit për kualifikimin e SME-ve.

Politikat industriale

- Projekt-vendim për harmonizimin e detyrimeve dhe këmbimin e të dhënave ndërmjet palëve (ministri, institucione, entet, subjekte private publike).
- Forcimi i kapaciteteve administrative.
- Likuidimi i ndërmarrjeve publike që nuk privatizohen.
- Listimi i pronës publike të mbetur.
- Privatizimi i pjesës shtetërore në Sh.p.k..
- Privatizimi i sha-ve publike.
- Rigrupimi i ndërmarrjeve për t'u privatizuar në grupe ndërmarrjesh industriale në bazë prefekturash.
- Projekt ligji "Për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjeve"

Sektori i SME-ve

- Implementimi i skemës së përdorimit të fondit për garantimin e kredive për SME-të eksportuese dhe i skemës së përdorimit të fondit për rritjen e konkurrencës së eksporteve.

- Studim fisibiliteti për ngritjen e një parku industrial në Durrës dhe projekti për krijimin e parkut industrial.
- Zbatimi i projektit “Për mbështetjen e SME-ve” duke menaxhuar programin 3-vjeçar për mbështetjen e SME-ve.
- Hartimi i një plani për zbatimin e RIAs në Shqipëri.
- Vlerësimi dhe monitorimi i planit të veprimit për reduktimin e ekonomisë informale.
- Zbatimi i projektit për përmirësimin e klimës së biznesit për reduktimin e pengesave administrative.
- Hartimi i ligjit “Për SME-të”, sipas rekomandimeve të BE-së.
- Projekti përmirësimi i menaxhimit të SME-ve (Technical Assistance Management).
- Hartimi i ligjit të e-signature.
- Projekti “Rritja e konkurrueshmërisë së SME-ve nëpërmjet novacionit dhe transferimit të teknologjisë”

Zhvillimi rajonal

- Projekt-ligji “Për zhvillimin rajonal”

Energjia

Energjia Elektrike

- Projektligji” Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 9072, datë 22.05.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike, i ndryshuar”;
- Projektligji” Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”;
- Rishikimi dhe miratimi i të gjithë kuadrit rregullator, si kodeve, licensave, rregullave të tregut, metodologjisë së llogaritjes së tarifave, etj.
- Vazhdimi i reformës tarifore për rishikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike.
- Përmirësimi i ligjit “Për disa ndryshime në ligjin ‘Për lehtësirat fiskale për ndërtimin e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike”.
- VKM “Për miratimin e Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike”
- Hartimi dhe miratimi me VKM i rregullave “Për auditimet energjetike”.
- VKM “Për ngritjen e Agjencive Rajonale të Energjisë”.
- VKM “Për funksionimin dhe kontrollin e fondit të eficensës së energjisë”

Hidrokarburet

- Hartimi i kuadrit rregullator, ligjor dhe teknik për tregun e brendshëm të gazit.
- Ristrukturimi dhe rifillimi i procesit të privatizimit të shoqërisë “ARMO”.
- Rritja e rolit rregullator të shtetit në drejtimin e cilësisë së nënprodukteve që tregtohen, rezervës së sigurisë.
- Ndjekja e procedurave të privatizimit të shoqërisë ARMO Sh.A ;
- Rritja e prodhimit vendas të naftës bruto në masën 10%;
- Bashkëpunimi me shoqëritë e huaja për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve.

- Hartimi i kuadrit bazë ligjore për prodhimin e biokarburantëve (është një indikativë e cila fillon në shtator 2007 dhe përfundon mars 2008).
- Diversifikimi i burimeve të furnizimit me naftë gas dhe nënprodukte duke studiuar mundësinë e lidhjes së Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të naftë e gaz - sjellësve.
- Zhvillimi i integruar (në sinergji) i zonës energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës, infrastruktura dhe konturet e saj,

Minierat

- Mbikëqyrja e shfrytëzimit efektiv të pasurive minerale.
- Monitorimi i fenomeneve post-shfrytëzimit.
- Projekte për mbyllje objektsh minerare.
- Promovimi i materialeve të reja për shfrytëzim.
- Studime dhe projektme për nevoja emergjente sipas kërkesave të pushtetit qendror e lokal.
- Studime komplekse në fushën e gjeomjedisit dhe monitorimi i tij.
- Studime komplekse në shërbim të miradministrimit të territorit dhe burimeve natyrore në shkallë vendi dhe lokale: gjeologjia-territori-mjedisi.
- Studimi dhe përafrimi i Direktivave të BE-së.
- Vlerësimi i rreziqeve gjeologjike, si dhe studime gjeologo-inxhinjerieke të specializuara për vlerësimin e qëndrueshmërisë dhe zgjerimin e infrastrukturës.
- Vlerësimi, menaxhimi dhe monitorimi i ujërave nëntokësore në basenet kryesore ujëmbajtës me përparësi zonat turistike, urbane etj .

Aneks 3 Investimet publike

Emërtimi i projektit të investimit	Kosto (në milion lekë)
Planifikim menaxhim Administrim	26
Blerje paisje për institucionin, investime IT, kosto lokale	26
Mbështetje për energjinë(AKBN)	9
Raport për Bilancin Energjetik te përvitshëm	6
Pergatitja e kuadrit nenligjor për eficensen e energjise	3
Mbështetje për minierat dhe ndërmarrjet publike	33
Blerje paisje laboratorit për RISHM	12
Albkrom Sh.a për mbyllje miniere	3
Albbakër Sh.a për mbyllje miniere	4
Albminiera Sh.a. për mbyllje minierash	8
Mbyllje ndërmarrje NFIM Elbasan	4
Mbyllje ndërmarrjesh Azotiku Fier	0.9
Mbyllje ndërmarrjesh Superfosfati Laç	0.4
Mbyllje ndërmarrjesh Goma Durrës	0.7
Mbështetje për burimet natyrore	265
Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	1650
Ujërat nëntokësore	19.5
Resurset minerale	11.5
Administ territorit dhe burimeve natyrore	36
Gjeomjedisi dhe monitorimi	23
Rreziqet gjeologjike e infrastruktura publike	19
Gjeoinformacioni	47
Blerje paisje dhe paisje laboratorike	6.5
Rikonstrukcion I zyrës	2.5
Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	100
Mbikqyrja e shfrytz. lirë rezervave minerale	11
Monit.i fenom.post shfrytëzimit të minerale	12
Adoptimi I direktivave te BE për 4 fusha projekt.	6
Promov.i minerale të rinj për shfirt+kerk tek. dhe mjedis	11
Dixhitalizimi i Industrisë minerale	40
Kopjimi i shiritave sizmik	20
Mbështetje për zhvillim ekonomik	183
Alinvest	178.5
Fondi i Konkurueshmerisë	25
Promovime tregtare	3.5
Ngritja e Rrjetit Energjetik dhe Telekomunikacionit Spitalë	150
ATRAKO	3
Paisje kompjuterike dhe orendi për zyrat	3
QKR	1.5
Paisje kompjuterike dhe orendi për zyrat	1.5

Mbikëqyrje tregut, infrast. cilësi dhe pronësi industriale	33.8
Drejtoria Akreditimit	2
Inspektorati Qendror Teknik	26
Ngritje e dy laboratorëve të Institutit Qendror Teknik	20
Paisje zyre dhe laborator	6
Drejtoria e Markave dhe Patentave	1
Drejtoria e Përgjithshme e Standarteve	0.8
Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	4

Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

Emërtimi i projektit	Grant/ kredi	Donatori	Vlera e projektit (në mln/lekë)	Plani 2008 (në mln/lekë)
Mbështetje për Energjinë				
Transformimi i tregut të ujit ngrohtë sanitar nga panelet diellore	Grant	PNUD/GEF	430	60
Për zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e emetimeve të gazrave me efekt sere”.	Grant	Qeveria Italiane	615	60
Zhvillimi ekonomik				
Mbështetje për SME	Kredi/(grant 2.5 mln EUR)	Q.Italiane	3.616	492
Mbështetje për politikat e SME-ve	Grant	BE/IPA2007	295	123
TAM (Technical Assistance Management) projekt	Grant	BE	123	61,5
BERIS	Kredi	Banka Botërore IBRD	944,6	344
Regjistrimi i biznesit	Grant	Qeveria Amerikane	24,6	12.3
Shërbime tregu, akreditim dhe inspektim				
Fuqizimi i kapaciteteve në fushën e ndihmës shtetërore	Grant	Cards 2005 Komisioni Evropian	24,6	12.3
Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Metrologjinë ligjore në Shqipëri	Grant	Komisioni Evropian CARDS 2006	147,6	49.2
Mbështetje për akreditim, standardizimin dhe Certifikimin në Shqipëri	Grant	CARDS 2006 Komisioni Evropian	98,4	32.8

Aneks 5 Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit

Në fushën rregullatore

- Ndjekja e zbatimit të parimeve të reformës rregullatore, parimi i miratimit të heshtur dhe parimi i autodeklarimit në përputhje me Planin e Veprimit në fushën e licencimit;
- Krijimi i një qendre "One stop shop" për lejet, licencat dhe autorizimet që lëshohen nga institucionet qendrore dhe institucionet në varësi të tyre, hartimi i kuadrit ligjor mbi bazën e të cilit do të funksionojë qendra "One stop shop" për lejet dhe licencat gjatë vitit 2009. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit dhe kuadrit ligjor të kësaj qendre.
- Përgatitja dhe dërgimi për miratim në Këshillin e Ministrave brenda 6-mujorit të parë 2008 të Raportit Vjetor për Ndhimat Shtetërore, me synim sigurimin e transparencës së përdorimit të fondeve publike. Kontrolli dhe publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në internet i skemave dhe ndihmave individuale.

Në fushën e privarizimit

- Rritja e transparencës në zhvillimin e ankandeve për asetet e sh.a-ve në likuidim dhe të pasurive shtetërore që u jepen me qera të tretëve, në kuadër të administrimit të pronës shtetërore.
- Përgatitja dhe monitorimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor për privatizimin e çdo shoqërie strategjike (ARMO, OSSH - Operatori i Sistemit të Shpërndarjes). Administrimi i procesit përmes Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës për privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë të ekonomisë (KKT), në bazë të VKM nr. 621, datë 25.09.1998 (ndryshuar me konsulencë ndërkombëtare). Prokurimi dhe tenderimi i këtyre shoqërive në përputhje me standartet ndërkombëtare për prokurimin dhe tenderimin.
- Rritja e transparencës në zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike. Publikimi i kriterëve për marrjen e statusit të zhvilluesit, operatorit dhe përdoruesit të zonave ekonomike, dokumentacionit të kërkuar, procedurat e garës për marrjen e licencës së zhvilluesit, kriteret e përzgjedhjes dhe vlerësimit, si dhe aksesit i drejtpërdrejtë i tyre në faqen elektronike të ministrisë.

Në fushën e politikave

- Zgjerimi i partneritetit ndërmjet strukturave në përbërje dhe vartësi të METE me shoqëritë vendase dhe të huaja që operojnë në sektorin energjetik hidrokarbur dhe atë mineral, për tërheqjen e mendimeve për problematikën e zbatimit të politikave në këto sektorë.
- Forcimi kapaciteteve për monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe strategjive sektoriale, përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore për zbatimin e strategjive dhe programeve.
- Monitorimi i zbatimit të buxhetit dhe programeve të METE me synim rritjen e eficiencës së menaxhimit të burimeve, publikimi në internet i planit të prokurimeve për vitin 2008.
- Fuqizimi i kontrollit të brendshëm në fushat për të cilat METE është përgjegjëse, përfshirë institucionet e vartësisë së METE që administrojnë marrëveshje dhe kontrata që kanë të bëjnë me investimet në këta sektorë.
- Zbatim korrekt i kërkesave të etikës brenda METE dhe në marrëdhëniet ndër-institucionale.